



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJEVE TË DISA QV-VE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGNET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 25.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të disa qendrave të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V E R E N

Kryetari i Bashkisë Kolonjë me shkresën nr. 12159 prot., datë 24.06.2019, ka kërkuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr.4075 nga Shkolla ne Qendër Shëndetësore.

Dhënia e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes, kërkohet pasi gjëndja infrastrukturore e Shkollës është ë papërshtatshme.

Kzaz nr.61, Bashkia Mallakastër, në përmbushje të detyrës, ka kryer verifikimin e ambienteve të qendrave të votimit nga ku konstatuar problematika me kushtet që kanë disa nga qendrat e votimit. Konstatimi i KZAZ nr.61 mbështet edhe nga prefekti me shkresën dërguar KQZ-së nr. 11804, prot. dt. 17.06.2019.

Në këto kushte KQZ ka kërkuar verifikimin e qendrave të votimit përmes Inspektorit Rajonal Zgjedhor për qendrat e votimit të referuara me probleme. Nga raporti i dërguar nga IR me nr.12112 prot., datë 21.06.2019, rezulton që :



- QV nr.3230, 3230/1 të caktuara tek ish gjykata, është në rikonstruksion dhe nuk mund të jetë gati për zgjedhjet e 30 qershorit.
Propozohet që QV nr. 3230, 3230/1 të vendosen në zyrat pranë ndërmarrjes së Naftës.
- QV nr.3226, 3226/1 të caktuara tek Muzeu, është kthyer në magazinë për bazën materiale të ish shtëpisë së kulturës.
Propozohet që QV nr. 3226 të vendoset në godinën e sigurimeve shoqërore, dhe QV nr.3226/1 në Zyrat e Punës.
- QV nr.3229, 3229/1 të caktuara tek Shkolla "Besëlidhja", është në rikonstruksion dhe nuk është marrë në dorëzim nga investitori.
Propozohet që QV nr. 3229, 3229/1 të vendosen në Zyra Arsimore.
- QV nr. 3217 e caktuar në qendrën shëndetësore, është në rikonstruksion dhe nuk mund të jetë gati për zgjedhjet e 30 qershorit.
Propozohet që QV nr. 3217 të vendoset në Shkollën 9-vjecare "Ramiz Aranitasi".
- QV nr. 3263 e caktuar në Shkollën 9-vjeçare, është e rrënuar.
Propozohet që QV nr. 3263 të vendoset në ndërtesën private të z.Baftjar Beluli.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të QV-ve sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kryetari i Bashkisë të publikojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, caktuar me këtë vendim.
3. Kryetari i Njesisë së Qeverisjes Vendore të njoftojë menjëherë zgjedhësit, për vendndodhjen e qendrës së votimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

